# INFORMATOR

## QENDRA E BIZNESIT

## GJILAN

**Gjilan, dhjetor 2011**

## Përmbajtja:


1. Qendra e Biznesit……………………………………………………..………………...3
    - 1.1. Misioni i qendrës së Biznesit……………………………………………….......4
    - 1.2. Vizioni…………………………………………………..……………….......4
    - 1.3. Qëllimi i Qendrës së Biznesit…………………………………………………….5
    - 1.4. Organizimi i Qendrës së Biznesit……………………………….………...6
2. Shfrytëzuesit e Qendrës së Biznesit…………………………………………………..…7
3. Përfitimet nga Qendra e Biznesit…………………………………………..………….7
    - 3.1. Përfituesit aktual në Qendrën e Biznesit……………………………………….8
4. Qendra e Biznesit ofron këto shërbime…………………………………….………..…9
5. Aktivitete të shumta në qendrën e Biznesit……………………………….………...10
    - **5.1.** “Bashkëpunimi ndërmjet Institucioneve të Regjionit Lindje dhe Organizatave me qëllim të mbështetjes së Fermerëve, Bizneseve të Vogla dhe të Mesme”………………………………….…….10
    - 5.2. Ligjërata për ISO-Standardet………………………………………………….11
    - 5.3. Konferenca të ndryshme dhe udhëtime studimi …………………………………..12
6. Çka na duhen Trajnimet ………………………………………………………………15
7. Trajnimet e Qendrës së Biznesit……………………………………………..………...16
    - 7.1. Aftësi sipërmarrëse…………………………………………………………...17
    - 7.2. Kontabilitet dhe Menaxhment financiar…………………..……………………18

7.3. Strategjitë e Zhvillimit të Biznesit…………………………………………………19
7.4. Plan Biznesi…………………………………………………………………..19
7.5. Etika e Biznesit……………………………………..…………………...20
7.6. Marketing dhe Komunikim……………………………………………...21
7.7. Analizë Financiare…………………………………………………………22
7.8. Mjedisi i Biznesit…………………………………..…………………………22
7.9. Lidershipi (Udhëheqja)……………………………………………………….23
8. Bashkëpunimet e Qendrës së Biznesit…………………………………………………24
9. Grumbullimi dhe marrja e informatave……………………………………………..25
10. Broshura dhe Pyetësori i Qendrës së Biznesit………………………………………...27
11. Adresa e Qendrës së Biznesit……………………………………………………….28

# I. QENDRA PËR BIZNES NË RAJONIN E GJILANIT

**(Gjilan, Kamenicë, Novobërdë, Viti, Ferizaj, Kaçanik, Shtërpce dhe Hani Elezit)**




**Themelimi** i kësaj qendre është iniciativë e përbashkët e Komunës se Gjilanit, Odës Ekonomike të Kosovës dhe organizatës CARE International Kosovë..

**Qendra e biznesit përkrahet** nga grup ekspertësh vendas dhe ndërkombëtar. Kjo qendër është në kuadër të Projektit të Zhvillimit Ekonomik Regjional i realizuar nga **CARE – International** Kosovë, financuar nga **BE** dhe i drejtuar nga **Zyra e Bashkimi Evropian në Kosovë.**

## 1.1. MISIONI

Qendra e Biznesit ofron të gjitha shërbimet e nevojshme, informata, asistencë dhe trajnime, “I Can make a difference”

## 1.2. VIZIONI

Vizioni i QB-së është të përforcojë dituritë profesionale dhe ndihmojë zhvillimin e bizneseve në rajonin e Gjilanit.

# VISION





## 1.3. QËLLIMI

Për të përmirësuar zhvillimin ekonomikë në rajonin lindje të Kosovës, është thelëmuar Qendra e Biznesit ku ka siguruar një qendër rajonale të biznesit ideal.

Që po ndihmon burrat dhe gratë që aspirojnë për të filluar një biznes të ri, ndërsa njerëzit e bizneseve ekzistuese po ndihmon për të rritur ndërmarrjet e tyre me krijimin e  një ambienti më të favorshëm të biznesit.

Kjo qendër po mbështet krijimin e punësimit, së bashku me aktivitetet e synuara të biznesit, fermerëve, dhe bujqve.

Nevoja për trajnime lindë nga nevoja për progres, konkurrencë, përshtatje dhe kualifikim. Konsulentët, të cilët zhvillojnë trajnime të ndryshme janë ata që vlerësojnë, mbështesin, nxisin të mësuarin dhe dijen, përshtaten dhe ndryshojnë me ritmet që sjell vetë efekti “kohë”.

Bizneset sot në Kosovë duhet të aplikojnë praktika dhe lloje të ndryshme trajnimesh duke iu përshtatur nevojave dhe kapaciteteve të tyre në mënyrë që të jenë pjesë e tregut.

## 1.4. Organizimi i Qendrës se Biznesit



## 2. SHFRYTËZUESIT E QENDRËS SË BIZNESIT



- ✓ Udhëheqësit
- ✓ Ndërmarrësit
- ✓ Fermerët
- ✓ Nëpunësit publikë
- ✓ Autoritetet qeveritare dhe lokale
- ✓ Udhëheqës të organizatave joqeveritare

# 3. PËRFITIMET NGA QENDRA E BIZNESIT

Qendra për biznes është partneri i juaj për t'ju aftësuar në pikëpamje profesionale dhe organizative, këtë e bën me trajnimet falas të cilat mbahen nga konsulentë-profesorë ndërkombëtarë dhe vendorë.

Trajnimi është një proces i cili kalon në disa faza, një ndër fazat e tij është dhe vlerësimi i trajnimit. Nëpërmjet vlerësimit të trajnimit ne identifikojmë pikat e dobëta dhe të forta të programit trajnues, vlerësojmë nëse ajo çka do mësohet gjatë trajnimit është në shërbim të nevojave të punës, si dhe bëhet një bilanc se sa shumë kanë mësuar të trajnuarit gjatë trajnimit.

Gjatë ecurisë së trajnimeve Stafi i Qendrës së Biznesit do të monitoroj punën e çdo konsulenti , ku pas përfundimit të trajnimit me anë të një pyetësori do të vlerësojmë punën e konsulentit me përfituesit e trajnimeve. Në njërën anë do të kemi pyetësor ku vlerësohet konsulenti, ndërsa në anën tjetër do të ketë pyetësor ku vlerësohen njohurit e përfituesve të marrë nga konsulenti.



***Nëse dëshironi të jeni i suksesshëm, zgjidhja juaj më e mirë është "QENDRA E BIZNESIT"***

### 3.1. Përfituesit aktual në QB-it

Përfituesit aktual në Qendrën e Biznesit janë gjithsej 256 persona të regjistruar në Qendrën e Biznesit. Të gjitha këto biznese janë të fushave të ndryshme (si tregtar, shërbimeve, transportit ndërtimtar,..etj) , po ashtu edhe nga qytetet e ndryshme por pa tjetër të regjionit lindje. Të gjithë këta përfitues kanë marrë informata të ndryshme nga Qendra e Biznesit rreth mundësisë së tyre për ndihmë në punët e tyre të përditshme si mbajtjen e librave, zgjerimin e biznesit, mundësisë për të aplikuar për grante të ndryshme etj.

Nga 256 persona të regjistruar në Databasë e Qendrës së Biznesit, 120 i kanë shfrytëzuar trajnimet të cilat janë mbajtur në Qendrën e Biznesit. Trajnime të cilësuara nga vetë përfituesit si shumë të qëlluara sepse u kanë ndihmuar shumë në punët e përditshme të bizneseve të tyre.

## 4. QENDRA E BIZNESIT OFRON KËTO SHËRBIME:



- Ofron asistencë në themelimin e bizneseve të reja
- Shërbime të ndryshme, si lidhjen me biznese tjera
- Siguron informacione dhe burime të bazuara në dokumentacionin për komunitetin e biznesit në përgjithësi
- Te siguroj mundësi marketingu në nivel lokal,regjional dhe nacional nëpërmjet lidhjeve të saja në Odën e biznesit
- Te siguroj këshilla të mjaftueshme dhe shërbimet të tjera për regjistrimin e biznesit
- Siguron më shumë asistencë në gjetjen e fondeve dhe përpilimin e aplikacionit
- Trajnimet paraqiten nga Specialistë të Cilësisë me përvojë të gjatë pune dhe profesionale në fushën e tyre
- Certifikatë nga organizata CARE International për pjesëmarrje ose përfundimin me sukses të trajnimeve
- Prospekte shtesë & Materiale elektronike,..etj

# 5. AKTIVITET TË NDYSHME JANË ZHVILLUAR NË QENDËR TË BIZNESIT

## 5.1. “Bashkëpunimi ndërmjet Institucioneve të Regjionit Lindje dhe Organizatave me qëllim të mbështetjes së Fermerëve, Bizneseve të Vogla dhe të Mesme”



Foto nga takimet

Ky takim bashkoi organizatat relevante, partnerë ndërkomunal, sektorin e bujqësisë, dhe akterët të zhvillimit rural nga Rajoni Lindje.

Qendra e Biznesit do të donte të punoj së bashku me të gjithë, për prezantimin dhe shpalosjen e programeve për projektet që kanë organizatat tuaja në Regjionin Lindje, ndarjen e përvojave dhe të informatave që do të sigurojë bashkëpunim të ngushtë në lidhje me zhvillimin në këtë Regjion.

Në takim kanë marrë pjesë, Kryetari i Komunës së Gjilanit z. Qemajl Mustafa, përfaqësues nga: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjensioni për Zhvillim në Regjionin Lindje (RDA), Drejtorët e Drejtorive të Bujqësisë të Regjionit Lindje, Drejtorët të Drejtorive të

Ekonomisë të Regjionit Lindje, Biznese nga të gjitha komunat e Regjionit Lindje, Fermer, Bletare dhe Buqë nga i gjithë Regjioni, etj.

Ky takim parashikoi aktivitete të veçanta duke i takuar  në një vend të gjitha organizatat relevante të partnerëve ndërmjet komunave në Regjionin e Lindje, në sektorit e bujqësisë,  zhvillimin e turizmit rural dhe  zhvillimit ekonomik, ...




Pamje nga takimi i mbajtur në Qendrën e Biznesit tema: “Bashkëpunimi ndërmjet Institucioneve të Regjionit Lindje dhe Organizatave me qëllim të mbështetjes së Fermerëve dhe Bizneseve të Vogla dhe të Mesme”

## 5.2. LIGJËRATA NGA EKSPESTI PER ISO- STANDARTET

Në 175 shtete të botës, sot aplikohen standardet e cilësisë, të Organizatës Ndërkombëtare të standardeve, të njohur si ISO derisa edhe Kosova duhet që të zbatojë këto masa, nëse pretendon që të jetë konkurrente në tregjet e ndryshme ndërkombëtare.  Në një takim me bizneset në Gjilan, për

ISO standardet në Kosovë, të organizuar nga Qendra e Biznesit, është thënë se edhe te ne ka filluar certifikimi i kompanive me këto standarde, që nënkupton certifikim të cilësisë së një prodhimi, ose shërbimi.




Për më tepër, certifikimi me ISO standarde do të thotë rritje e besueshmërisë te klientët. “ISO standardet sigurojnë rritje të cilësisë së prodhimit dhe shërbimit si dhe përmirësim të pasqyrave financiare”, Kështu që nënkupton se një kompani që nuk është e certifikuar me këto standarde, nuk mund të hyjë në konkurrencë me kompanitë tjera, në asnjë tender, pavarësisht prej çmimit që ofron.

## 5.3. KONFERENCA TË NDRYSHME DHE UDHËTIME STUDIMI



Konferencë  për potencialet ekonomike në Regjionin Lindje




Koordinimi ndërmjet projekteve të EUred



Takime në Universitetin e Tetovës, si dhe ndarja e përvojave nga të dy anët




Udhëtime zyrtare me përfaqësuesit e komunave të drejtorive të bujqësisë, zyrës së projekteve dhe zyra e regjistrimit të bizneseve dhe ekonomisë



Fabrika e kultivimit të peshkut në Strugë (Maqedoni)



Udhëtime zyrtare – Studimi në zhvillimin e sektorit të bujqësisë

## 6. CKA NA DUHEN TRAJNIMET ?



Të gjithë bizneset kanë nevojë që të kenë punonjës dhe drejtues me aftësi dhe njohuri të mjaftueshme për të kryer punën e tyre. Sa herë që ekziston vullneti dhe dëshira që punonjësit dhe drejtuesit të mësojnë njohuri të reja apo njohuri për ndonjë produkt të ri, atëherë bizneset menjëherë mendojnë për trajnimet. Një prej metodave më të shpejta që aktualisht po rritet gjithnjë e më shumë ne regjionin tone është trajnimi.

Kështu, bizneset mund të krijojnë mundësi që punonjësit e tyre të mësojnë në Qendrën e Biznesit që do të ndjekin modulet në mënyrë individuale. Të gjitha modulet janë aq të përshtatshëm sa mund të lejojnë çdolloj numri të punonjësve si biznese të vogla, biznese të mëdha, fermer, bujq, etj… në të njëjtën kohë.

Trajnimet e Biznesit përqendrohen te punonjësit dhe drejtuesit e biznesit dhe synojnë përmirësimin e aftësive të tyre në një fushë të caktuar shembull, në Marketing dhe Komunikim, Analizë Financiare, Kontabilitet dhe Menaxhment Financiar, etj. Këto Trajnime (Module) synojnë të japin informacion në një periudhë të shkurtër kohe (një modul është dy javorë), zakonisht janë të shkurtër dhe në përgjithësi llogariten në bazë të numrit të orëve. Pas përfundimit të trajnimeve jepen certifikata zyrtare nga CARE  International. Megjithatë, njohuritë e fituara nga trajnimi e bëjnë më të lehtë çdo hap tjetër në të mësuarit akademik, që individët mund të dëshirojnë të kryejnë në të ardhmen.

Trajnimet në Qendrën e Biznesit mundësojnë punonjësit të mësojnë dhe të marrin njohuri të reja gjatë një periudhe kohore të caktuar dhe në një ritëm të përshtatshëm për ta. Trajnimi mund të jetë në një fushë të caktuar (shumë i dobishëm për punonjësit e rinj) ose mund të japë njohuri të përgjithshme me synimin për të përmirësuar punën e punonjësit.

Në pozitat e drejtuesit të një biznesi të vogël, shpesh disa punë të rëndësishme duhet të bëhen nga ata vetë. Kështu, atyre u duhet të merren më shitjet, marketingun dhe kontabilitetin, si edhe me drejtimin e përditshëm të biznesit. Trajnimet bëjnë të mundur që këta drejtues të mësojnë për çdo fushë të biznesit ku ata e ndjejnë se kanë nevojë të përmirësohen dhe të kenë njohuri të mjaftueshme për të bërë të gjitha punët e kërkuara në biznes. Megjithëse trajnimi është parë si për punonjësit ashtu edhe për drejtuesit, pasi ata mund të rrisin njohuritë dhe të përmirësojnë mënyrën e të drejtuarit të biznesit. ***Për shembull, kur dikush dëshiron të hapë një biznes, fillimisht mund të bëjë trajnime për të mësuar për mënyrat dhe praktikat kryesore të biznesit, të cilat mund ta ndihmojnë për krijimin dhe drejtimin e biznesit.***

# 7. TRAJNIMET E QENDRËS SË BIZNESIT




Nga kjo qendër ju mund të fitoni njohuri te mjaftueshme dhe profesionale, duke mos pasur ngarkesë pagat për to, kjo është një mundësi pikërisht nga organizata CARE-international, projekt i Bashkimit Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Prishtinë. Qendra e Biznesit ju ofron këto trajnime (module), si pasojnë në vijim:

## 7.1. AFTËSI SIPËRMARRËSE



Konsulenti ofron alternativa për zgjedhjen dhe parandalimin e problemeve që po hasin bizneset e vogla dhe të mesme, aftëson pjesëmarrësit në punëtori që të rrisin bizneset e tyre, ofron shërbime këshillimi profesional për një mori biznesesh me qëllim arritjen e suksesshme të bizneseve të tyre, konkretisht ruajtjen dhe rritjen e pozicionit në treg të kompanive, informimin e bizneseve rreth ndodhive në tregun e brendshëm dhe të jashtëm, mundësinë e lidhjeve me bizneset rajonale dhe ndërajonale.

## 7.2. KONTABILITET DHE MENAXHMENT FINANCIAR



Aftësimi i përfitueseve të trajnimeve për realizimin në praktikë të teorive dhe të detyrave nga lënda e kontabilitetit.

Të parapërgatiten përfituesit e trajnimeve tona me aftësi të mjaftueshme për mbajtjen, përcjelljen dhe kontrollin e evidencës kontabël si dhe formave të ndryshme të veprimit.

Të aftësohen përfituesit, që në mënyrë më të lehtë të kualifikohen edhe në nivelet më të larta si kontabilist i certifikuar ose auditorë.

## 7.3. STRATEGJITË E ZHVILLIMIT TË BIZNESIT



Të analizojë në detaje procesin e planifikimit strategjik të një biznesi nëpërmjet: Vlerësimit të fuqive dhe dobësive të firmës, Studimit dhe parashikimit të mjedisit të jashtëm të firmës dhe si rezultat përcaktimin e shanseve dhe kërcënimeve që i vinë firmës nga mjedisi i jashtëm, hartimit të misionit, qëllimeve dhe objektivave të firmës, formulimit dhe zbatimit të planeve për arritjen e qëllimeve dhe objektivave, t'i familjarizojë studentët me metodat e drejtimit të bizneseve, duke ilustruar teorinë me shembuj konkretë nga praktika e bizneseve botërore.

## 7.4. PLANI I BIZNESIT



Nëpërmjet Planit të biznesit ne arrijmë të ambientohemi në situatën e brendshme ashtu edhe të jashtme,.Plani i biznesit duhet të përdoret si bazë nga i cili do të vlerësohen performancat. Rezultatet aktuale mund të krahasohen me plan vetëm kur me te vërtet plani ekziston. A janë rezultatet tona në nivel të profitabilitetit?. Nëse jo, çfarë përmirësime duhet të bëjmë në sjelljet tona për ta përmirësuar prodhimtarinë në të ardhmen?.

Përfundimisht, plani i biznesit mund të përdoret në rastet e paraqitjeve të kërkesave për mbështetje financiare, siç janë aplikimet për kredi. Përderisa sektori i kreditimit zhvillohet në Kosovë, bankat do të mbështesin bizneset, të cilat qartë do të shprehin të ardhmen e tyre, dhe të cilët e kanë të evidentuar mënyrën që do të arrijnë atje. Megjithatë, duhet të jeni të kujdesshëm. Kundërshto nëse duhet shkruar plani i biznesit vetëm pse mendon se kjo është diçka që banka dëshiron ta shoh. Planin e biznesit duhet ta shkruani kryesisht për t'u shfrytëzuar nga pronarët dhe menaxherët e biznesit.

## 7.5. ETIKA E BIZNESIT



Janë disa objektiva kryesore që synohen të arrihen në kuadër të organizimit dhe mbajtjes së këtij moduli. Objektivi kryesor i këtij kursi është aftësimi dhe trajnimi i përfituesve me konceptet dhe

faktorët kryesorë të biznesit si fenomen shkencor dhe praktik. Njohuritë të cilat përfituesi do të arrijë ti fitojë me përfundimin e këtij moduli do të jenë njohuri dhe ndryshime radikale sa i përket përgatitjes së tij profesional.

## 7.6. MARKETING DHE KOMUNIKIM




Kjo lëndë siguron klientët me njohuri bazë për kërkimin marketing, si një nga fushat e marketingut që ndihmon ndërmarrjen të mbledhë informacion të shumëllojshëm dhe të domosdoshëm, ta përpunojë dhe të analizojë atë  për të nxjerrë përfundime në shërbim të menaxherit marketing. Në botën e sotme informacioni ka shumë rëndësi dhe kërkimi marketing është një fushë e marketingut që siguron input për strategjinë dhe për të gjithë menaxheret në kompani.

Cikli i modulit është ndarë në disa pjesë, por përveç pjesës së hyrjes ku jepen konceptet kryesore, pjesët e tjera lidhen në mënyrë koherente me vazhdimësinë e procesit të kërkimit.

## 7.7. ANALIZË FINANCIARE



Fitimi i njohurive të përgjithshme teorike dhe praktike, nga fusha e analizës financiare, si mundësi reale për krijimin e kuadrove që synojnë vlerësimin e gjendjes financiare të subjekteve, pozicionin financiar në të kaluarën dhe në të tashmen..

## 7.8. MJEDISI I BIZNESIT



Fitimi i njohurive të reja të natyrës teorike nga fusha e mjedisit të biznesit. Ofrimi i mundësive për njohjen e mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm, faktorëve ndikues dhe zbatimin e njohurive të fituara, për vlerësimin e faktorëve që ndikojnë te subjektet (bizneset) për ushtrimin e veprimtarive prodhuese dhe shërbyese si dhe realizimin e objektivave te organizatat qeveritare dhe të atyre jofitim prurës.

## 7.9. LIDERSHIPI (UDHËHEQJA)



Lënda “Lidership (udhëheqja)” ka si synim kryesor të pajisë studentët me njohuritë bazë më bashkëkohore në fushën e menaxhimit të organizatave private dhe publike me një fokus të veçantë në organizatat që operojnë në fushën e turizmit. Programi i lëndës është konceptuar si tërësi njohurish themelore, të cilat do të thellohen më tej nga studentët në vitet e mëvonshme. Duke u bazuar në këtë mënyrë konceptimi, programi i lëndës përfshin njohuri të domosdoshme mbi konceptin e menaxhimit dhe rolin e tij në shoqëri, paraqitjen e sfondit historik të zhvillimit të shkencave menaxheriale, identifikimin dhe sqarimin e funksioneve bazë menaxheriale (planifikim, organizim, udhëheqje & motivim, kontroll).

Një rëndësi e veçantë i kushtohet sqarimit të aspekteve teorike - praktike të lidership-it dhe sjelljes menaxheriale, si dhe identifikimit të faktorëve të mjedisit të jashtëm menaxherial. Në këtë lëndë studenti prezantohet dhe me konceptet e para të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe biznesit ndërkombëtar. E gjithë lënda është përshtatur në funksion të tendencave moderne në fushën e menaxhimit dhe në industrinë e turizmit.

## 8. Bashkëpunimet e Qendrës së biznesit

- ✓ Komuna e Gjilanit
- ✓ Komuna e Kamenicës
- ✓ Komuna e Ferizajt
- ✓ Komuna e Vitisë
- ✓ Komuna e Hanit Elezit
- ✓ Komuna e Kaçanikut
- ✓ Komuna e Novobërdës
- ✓ Komuna e Shtërpcës
- ✓ RDA East (AZHR)
- ✓ Fondi Struktural i Hortikulturës
- ✓ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- ✓ Ministria e Financave
- ✓ Oda Ekonomike (dega në Gjilan)
- ✓ Bankat që operojnë në Kosove
- ✓ Universiteti i Prishtinës
- ✓ USAID (Programi Mundësitë e reja për Bujqësi në Kosovë)

## 9. Grumbullimi i bizneseve dhe marrja e informatave

Grumbullimi i bizneseve dhe marrja e informatave është bërë përmes dy formave kryesore, siç janë:

### 1. Me ndihmën e komunave



## 2. Intervista të drejtpërdrejta me bizneset



# 10. Broshura dhe Pyetësori i QB-së

Qendra e Biznesit ka krijuar edhe broshurën me të cilën është shërbyer ne informimin e bizneseve, po ashtu edhe pyetësori për intervistim.






An EU funded project managed by the European Commission Liaison Office

PYETËSOR PËR BIZNESET E VOGLA DHE TË MESME

I. Të dhënat mbi pronarin e biznesit

1) Emri ____________________ 2) Mbiemri ____________________
3) Tel. ____________________ 4) E-mail ____________________

II. Lloji i biznesit

1) Prodhim 2) Shërbime 3) Bujqësi 4) Ndërtimtari 5) Tregëti

III. Vendi i biznesit

1) ____________________

IV. A keni ndjekë ndonjë trajnim profesional për zhvillimin e biznesit?

1) PO 2) JO

V. A e dini që është themeluar QENDRA PËR BIZNES nga CARE- International dhe Komuna e Gjilanit?

1) PO 2) JO

VI. A dëshironi të ndiqni trajnimet ( shërbimet ) që ju ofron Qendra për Biznes?

1) PO 2) JO

VII. Nëse PO, në cilën nga këto fusha jeni të interesuar ?

1) Aftësi sipërmarrje 2) Kontabilitet dhe menaxhment financiar 3) Plan Biznesi
4) Lidership (udhëheqje) 5) Strategjitë e zhvillimit të biznesit 6) Etika e biznesit
7) Analiza Financiare 8) Marketing dhe komunikim 9) Mjedisi i biznesit

VIII. Nëse keni diçka të shtoni apo ndonjë porosi për CARE –International apo Komunën e Gjilanit? (Vërejtje)

________________________________________
________________________________________

An EU funded project managed by the European Commission Liaison Office and implemented by care

# 11. ADRESA E QENDRËS SË BIZNESIT:




**Komuna:** Gjilan

**Rruga:** Dardania I

**Adresa:** Inkubatori i biznesit ( kati i III-të, nr. 15)

**Tel:** 0280 / 327 - 323

**E-mail:** Hidajete.Jashari@co.care.org



## SHTOSJA:

## BIZNESIT E REGJISTRUARA PER TRAJNIME NE QENDREN E BIZNESIT

| Nr. | EMRI DHE MBIEMRI | VENDI | TRAJNIMI (MODULI) |
|---|---|---|---|
| 1 | 1.HYSNIJE ISMAILI | GJILAN | Lidership |
| 2 | 2.MIRLINDA DULAHU | GJILAN | Lidership |
| 3 | 3.VJOSA DAKU | GJILAN | Lidership |
| 4 | 4.HEKURAN ISMAILI | GJILAN | Lidership |
| 5 | 5.TRINGA SALIHU | GJILAN | Lidership |
| 6 | 6.VILDANE MORINA - AGUSHI | GJILAN | Lidership |
| 7 | 7.KUSHTRIM MUSTAFA | GJILAN | Lidership |
| 8 | 8.ISMET LIMONI | GJILAN | Lidership |
| 9 | 9.VALDETE FETAHU | GJILAN | Lidership |
| 10 | 10.NAFIE MEMETI | GJILAN | Lidership |
| 11 | 11.NASER LATIFAJ | GJILAN | Lidership |
| 12 | 12.MIRANDA JASHARI | GJILAN | Lidership |
| 13 | 13.ELHAME SYLA | GJILAN | Lidership |
| 14 | 14.SHQIPE SYLEJMANI | GJILAN | Lidership |
| **Nr.** | **EMRI DHE MBIEMRI** | **VENDI** | **TRAJNIMI (MODULI)** |
| 15 | 1.LIRIDONA KADRIU | GJILAN | Aftesi Sipermarrese |
| 16 | 2.NORA MUSLIU | GJILAN | Aftesi Sipermarrese |
| 17 | 3.FEIME BUNJAKU | GJILAN | Aftesi Sipermarrese |
| 18 | 4.ARTA BAJRAMI | GJILAN | Aftesi Sipermarrese |
| 19 | 5.SHQIPE LATIFI | KMETOVC | Aftesi Sipermarrese |
| 20 | 6.XHEVAT XHOKLI | FERIZAJ | Aftesi Sipermarrese |
| 21 | 7.SAMI SYLA | GJILAN | Aftesi Sipermarrese |
| 22 | 8.SHPEND IDRIZI | GJILAN | Aftesi Sipermarrese |
| 23 | 9.ZIJAVERE LEKA | GJILAN | Aftesi Sipermarrese |
| **Nr.** | **EMRI DHE MBIEMRI** | **VENDI** | **TRAJNIMI (MODULI)** |
| 24 | 1.DENIZ KADRIU | GJILAN | Marketing dhe Komunikim |
| 25 | 2.ARBER ISMAILI | GJILAN | Marketing dhe Komunikim |
| 26 | 3.DONJETA DEMA | GJILAN | Marketing dhe Komunikim |
| 27 | 4.GANIMETE HOTI | GJILAN | Marketing dhe Komunikim |
| 28 | 5.MIRSIJE ADEMI | GJILAN | Marketing dhe Komunikim |
| 29 | 6.MIRUSHE LATIFI | KMETOVC | Marketing dhe Komunikim |
| 30 | 7.FIKRIJE LATIFI | KMETOVC | Marketing dhe Komunikim |
| 31 | 8.LUMBARDH BEHLULI | GJILAN | Marketing dhe Komunikim |
| 32 | 9.PETRIT VOKSHI | GJILAN | Marketing dhe Komunikim |

| Nr. | EMRI DHE MBIEMRI | VENDI | TRAJNIMI (MODULI) |
|---|---|---|---|
| 33 | 1.BASHKIM LATIFI | KMETOVC | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 34 | 2.SELIAB HAXHAMI | HANI ELEZIT | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 35 | 3.MEXHAHIT KALISI | HANI ELEZIT | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 36 | 4.ARBEN KRYEZIU | DARDANE | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 37 | 5.SHUKRIJE RRUSTEMI | GJILAN | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 38 | 6.GEZIM BUNJAKU | GJILAN | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 39 | 7.SABIT NEZIRI | GJILAN | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 40 | 8.ALBULENE ZUBAKU | GJILAN | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 41 | 9.MUHARREM KRYEZIU | DARDANE | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 42 | 10.LEOTRIM QERIMI | GJILAN | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 43 | 11.XHEJLANE VOKSHI | GJILAN | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 44 | 12.FLORENTINA BUCALIU | GJILAN | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 45 | 13.BURIM GOVORI | GJILAN | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 46 | 14.FLORENT KASTRATI | KMETOVC | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 47 | 15.ALBULENA LATIFI | KMETOVC | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 48 | 16.SERVET SUMA | HANI I ELEZIT | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| 49 | 17.ALI AXHAMI | HALI I ELEZIT | Kontabilitet dhe M.Financiar |
| **Nr.** | **EMRI DHE MBIEMRI** | **VENDI** | **TRAJNIMI (MODULI)** |
| 50 | 1.IZER ZEQIRI | GJILAN | Mjedisi I Biznesit |
| 51 | 2.FLORIM ARIFI | GJILAN | Mjedisi I Biznesit |
| 52 | 3.BEJTULLAH BERISHA | GJILAN | Mjedisi I Biznesit |
| 53 | 4.KORAB SADIKU | GJILAN | Mjedisi I Biznesit |
| 54 | 5.DRITON NUHIU | GJILAN | Mjedisi I Biznesit |
| 55 | 6.ARTAN BAJRALIU | GJILAN | Mjedisi I Biznesit |
| 56 | 7.BAJRAM ROBELLI | GJILAN | Mjedisi I Biznesit |
| **Nr.** | **EMRI DHE MBIEMRI** | **VENDI** | **TRAJNIMI (MODULI)** |
| 57 | 1.KORAB HYSENI | GJILAN | Stratigjite e Zh. Biznesit |
| 58 | 2.ARBEN SELMANI | GJILAN | Stratigjite e Zh. Biznesit |
| 59 | 3.ARBER SHAQIRI | GJILAN | Stratigjite e Zh. Biznesit |
| 60 | 4.SHKUMBIN BILALLI | GJILAN | Stratigjite e Zh. Biznesit |
| 61 | 5.MUJE IBRAHIMI | PERLEPNIC | Stratigjite e Zh. Biznesit |
| 62 | 6.ERKANDA SHAQIRI | GJILAN | Stratigjite e Zh. Biznesit |
| 63 | 7.HAVA SADIKU | GJILAN | Stratigjite e Zh. Biznesit |
| 64 | 8.ELVIR IMAMI | GJILAN | Stratigjite e Zh. Biznesit |
| 65 | 9.XHEVXHET-Z-ADEMI | VITI | Stratigjite e Zh. Biznesit |
| **Nr.** | **EMRI DHE MBIEMRI** | **VENDI** | **TRAJNIMI (MODULI)** |
| 66 | 1.ERZA MUSTAFA | GJILAN | Analiza Financiare |
| 67 | 2.EGZONA IMERI | FERIZAJ | Analiza Financiare |
| 68 | 3.FARI SHKRETA | HANI I ELEZIT | Analiza Financiare |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 69 | 4.BESNIK REQI | HANI I ELEZIT | Analiza Financiare |
| 70 | 5.QENDRESA MISINI | FERIZAJ | Analiza Financiare |
| 71 | 6.REMZIJE SADIKU | GJILAN | Analiza Financiare |
| 72 | 7.MUHABERE SADIKU | GJILAN | Analiza Financiare |
| 73 | 8.LIRIDONA LESKOVCI | FERIZAJ | Analiza Financiare |
| 74 | 9.NDRIQIM SMERQAKU | GJILAN | Analiza Financiare |
| 75 | 10.VILDANE BUNJAKU | GJILAN | Analiza Financiare |
| 76 | 11.VALON RAMADANI | GJILAN | Analiza Financiare |
| 77 | 12.SHUKRIJE MALOKU | GJILAN | Analiza Financiare |
| 78 | 13.ARTAN DULAHU | GJILAN | Analiza Financiare |
| 79 | 14.MENTOR HALILI | GJILAN | Analiza Financiare |
| 80 | 15.ALBULENA HAJDARI | GJILAN | Analiza Financiare |
| 81 | 16.BESARTA ABDULLAHU | GJILAN | Analiza Financiare |
| 82 | 17 LUMTURIJE LESKOVCI | FERIZAJ | Analiza Financiare |
| 83 | 18.RESMIJE SADIKU | GJILAN | Analiza Financiare |
| 84 | 19.LABINOTA GOVORI | GJILAN | Analiza Financiare |
| **Nr.** | **EMRI DHE MBIEMRI** | **VENDI** | **TRAJNIMI (MODULI)** |
| 85 | 1.ISMET XHELEDINI | GJILAN | Etika e Biznesit |
| 86 | 2.REFIK SADIKU | GJILAN | Etika e Biznesit |
| 87 | 3.FLAVIANA HALILI | GJILAN | Etika e Biznesit |
| 88 | 4.SADIK QERIMI | FERIZAJ | Etika e Biznesit |
| 89 | 5.RAJMONDA LATIFI | GJILAN | Etika e Biznesit |
| 90 | 6.LEONORA XHELILI | PERLEPNIC | Etika e Biznesit |
| 91 | 7.VENERA XHELILI | PERLEPNIC | Etika e Biznesit |
| 92 | 8.FITORE BAJRAMI | PERLEPNIC | Etika e Biznesit |
| 93 | 9.EDONA GASHI | GJILAN | Etika e Biznesit |
| 94 | 10.FITORE KORBI | GJILAN | Etika e Biznesit |
| 95 | 11.ARTAN REXHEPAJ | GJILAN | Etika e Biznesit |
| **Nr.** | **EMRI DHE MBIEMRI** | **VENDI** | **TRAJNIMI (MODULI)** |
| 96 | 1.BEHAR AJVAZI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 97 | 2.ARLINDA AHMETI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 98 | 3.VIOLETA SPAHIU | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 99 | 4.ARTA LATIFAJ | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 100 | 5.VJOLLCA HAZIRI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 101 | 6.ARBERESHA ISLAMI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 102 | 7.ARBER DEMIRI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 103 | 8.VLORA HASANI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 104 | 9. SHKURTE XHELILI | PERLEPNIC | Plani i Biznesit |
| 105 | 10.LIRIDONA CANI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 106 | 11.ZAHIDE KAMBERI | PERLEPNIC | Plani i Biznesit |
| 107 | 12.VENERA JASHARI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 108 | 13.FLORENT VRANJA | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 109 | 14.ENIS PAJAZITI | GJILAN | Plani i Biznesit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 110 | 15.FITORE HALIMI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 111 | 16.OSMAN DERGUTI | FERIZAJ | Plani i Biznesit |
| 112 | 17.ALDAN LUZHA | FERIZAJ | Plani i Biznesit |
| 113 | 18.ALBULENA NAZIFI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 114 | 19.FITORE GAGICA | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 115 | 20.ARBENITA GAGICA | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 116 | 21. DONJETA ZEQIRI | GJILA N | Plani i Biznesit |
| 117 | 22.DARDANE BEHLULI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 118 | 23.FARUK SHABANI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 119 | 24. SHKURTE NEZIRI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 120 | 25.EGZONA OSMONI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 121 | 26.VIOLETA VESELI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 122 | 27.FESTIM ZEQIRI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 123 | 28.EGZONA ZEQIRI | GJILAN | Plani i Biznesit |
| 124 | 29.ZEMRA ISMAILI | CERNIC | Plani i Biznesit |